



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
G.JYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU - BASIC COURT OF PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.6/24

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Kryetarja e gjykatës Shpresa Emra, duke vepruar sipas kërkesës për inicim të procedurës disiplinore të parashtruar nga ana e ankuesit R. V., respektivisht të avokatit të tij L. V., nga Prishtina, ndaj gjyqtarit F.K., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit sipas lëndës penale P.nr.945/22, në bazë të së cilës është bërë inicimi i procedurës disiplinore, me dt. 19.07.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e ankuesit R. V., respektivisht të avokatit të tij L. V., nga Prishtina, ndaj gjyqtarit F.K., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit sipas lëndës penale P.nr.945/22.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës R. V., respektivisht të avokatit të tij L. V., nga Prishtina, me datë 26.06.2024 ka parashtruar kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit F.K., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit sipas lëndës penale P.nr.945/22.

Ankuesi av.L. V., në cilësinë e avokatit të pales R. V., në lëndën me numër P.nr.945/22, e cila është zhvilluar ndaj të mbrojturit të tij R. V., me e mailin e datë 26.06.2024 i është drejtuar Kryetares së Gjykatës si Autoritet Kompetent duke kërkuar që të iniciohet procedura disiplinore ndaj gjyqtarit F.K., për shkak se, pasi që Gjykata e Apelit ka vendosur në mënyrë meritore, gjyqtari F.K., është dashur që vendimin e Gjykatës së Apelit, t'ia përcjellë edhe të pandehurit Ramë V., por edhe mbrojtësit të tij L. V.. Këtë obligim ligjor, nuk e ka kryer, duke e dërguar lëndën në arkivë, ndërsa R. V., dhe mbrojtësi i tij kanë mbetur në pritje të këtij vendimi. R. V., gjatë kësaj periudhe sa ka qenë në pritje të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, është dëmtuar, pasi që nuk ka pasur mundësi të aplikoj në një pozitë, ku i është pamundësuar për shkak të rastit të hapur, e që realisht ka qenë i mbyllur në arkivin e Gjykatës Themelore në Prizren. I mbrojturi i tij është interesuar personalisht dhe ka tentuar ta takoj gjyqtarin F.K., por

i njëjti nuk e ka pranuar në zyre për tërheqjen e aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, duke e udhëzuar që i njëjti ti drejtohet arkivës. Me këtë veprim gjyqtari F.K., ka bërë shkelje ligjore, pasi aktgjykimin e Apelit nuk i'a ka dërguar të mbrojturit të tij R. V., dhe përfaqësuesit të tij. Andaj, kërkohet që të fillohet procedura disiplinore kundër gjyqtarit F.K., për këtë shkelje të bërë.

Autoriteti kompetent - Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar ankesë ndaj gjyqtarit F.K., Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, lidhur me lëndën P.nr.945/22ka iniciuar hetimet preliminare për procedurë disiplinore dhe ka ndërmarrë disa veprime në këtë drejtim. Fillimisht ka bërë shikimin në ankesën e parashtruar, ka kërkuar deklaratë nga gjyqtari i çështjes si dhe ka bërë shikimin e shkresave të lëndës penale P.nr.945/22.

Gjyqtari në deklaratën e tij lidhur e pretendimet e ankuesit ka cekur se nuk qëndrojnë pretendimet e paraqitura në kërkesën e parashtruar, pasi që sipas kompetencës dhe rregullores së punës, vendimet e Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë i ekspedon nëpërmjet administratës së gjykatës ku një obligim i tillë i ekspedimit nuk i takon gjyqtarit gjykues të çështjes penale sepse nuk është kompetencë e tij. Administrata e gjykatës së shkallës së parë në afatin e saj ligjor i ka ekspeduar palëve në procedurë aktvendimin e Gjykatës së Apelit. Mos pranimit i aktvendimit nga pala dhe mos dorëzimi nga PTK-ja e Kosovës, duke mos qenë adresa e saktë e të akuzuarit, është kthyer aktvendimi i tillë, pasi që ka qenë e panjohur adresa e të akuzuarit. Një shpjegim më të plotë dhe më të saktë, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij e kanë marrë verbalisht nga përgjegjësi i administratës së gjykatës së shkallës së parë. Më tutje ka deklaruar se si gjyqtar gjykues në këtë çështje penale është e paarsyeshme dhënia e kësaj deklaratë, pa kurrfarë baze juridike e aq më pak kur kërkohet përgjegjësi disiplinore është e paarsyeshme.

Autoriteti kompetent - Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar deklaratën nga gjyqtari e çështjes, ka bërë verifikimin e shkresave të lëndës P.nr.945/22. Gjithashtu, ka kërkuar sqarim edhe nga administrata e gjykatës lidhur me ekspedimin e vendimit në fjalë.

Pas vlerësimit dhe analizës së tërësishme të provave të mbledhura Autoriteti Kompetent konsideron ss:

Ankesa është e pabazuar.

Autoriteti kompetent - Kryetarja pas verifikimit të gjithë dokumentacionit ka vërtetuar gjendjen faktike si Vijon:

Në Gjykatën Themelore në Prizren — Departamenti i Përgjithshëm — Divizioni Penal ka qenë në punë çështja penale ndaj të akuzuarit R. V., nga Prishtina, për shkak të veprës penale cenimi i drejtave të punësimit dhe të papunësisë nga neni 219 par. I dhe 2 të KPRK-së. Lidhur me këtë çështje gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin P.nr.945/22 të datës 06.04.2023, të akuzuarin e ka shpallur fajtor dhe ka gjykuar me dënim me gjobë në shumën prej 1500 (njëmijë e pesëqind) euro. Ndaj këtij aktgjykimi, mbrojtësi i të akuzuarit av.L. V., në afat ligjor ka parashtruar ankesë drejtuar Gjykatës së Apelit. Gjykata e Apelit me aktgjykim PAI.nr.779/23 të datës 20.03.2024 ka aprovuar ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit R. V., dhe ka ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.945/22, të datës 06.04.2023, ashtu që në mungesë të provave ka shpallur aktgjykim lirues.

Gjykata Themelore në Prizren, si gjykatë e shkallës së parë pas pranimit të aktgjykimit të

Gjykatës së Apelit, me datë 08.04.2024 ka bërë ekspedimin e këtij aktgjykimi palëve në procedurë, e Cila vërtetohet edhe nga konstatimi i bërë nga zyrtari përgjegjës lidhur me ekspedimin. Pas kësaj është kontaktuar me palën dhe avokatin e tij dhe është kërkuar adresa e saktë dhe numri i telefonit i të njëjtit. Pala R. V., me datë 01.07.2024 personalisht është paraqitur në gjykatë dhe ka pranuar aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAI .nr.779/23 të datës 20.03.2024, e Cila vërtetohet edhe nga nënshkrimi i fletëdërgesës për dorëzim personal.

Si Autoritet Kompetent konsideroj se në rastin konkret ankuesi nuk është deklaruar se ku qëndron baza ligjore e shkeljeve disiplinore në kuptim të Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Shkeljet disiplinore në këtë ligj janë cekur në mënyrë taksative dhe ankuesi është dashur që të specifikon ku konsiston shkelja e pretenduar e gjyqtarit F.K., cili veprim i gjyqtarit konsiston në shkelje ligjore sipas këtij ligji.

Sa i përket faktit se cilat janë detyrat e punës së ekspeditit dhe komunikimit me palë pas përfundimit të gjyqimit kjo detyrë sipas Rregullores nr.02/2020 për organizimin e brendshëm të Gjykatave të Kosovës është përcaktuar në nenin 21 dhe 21.2.23 ku ceket ”Zyra e menaxhimit të lëndëve mundëson procedimin e lëndëve në mënyrë transparente dhe me kohë. ZIML është përgjegjëse për lëvizjen e lëndëve brenda gjykatës dhe përcjelljen e tyre në gjykatat tjera , në regjistrim e deri në përfundimin e saj , si dhe ofron shërbime për nevoja të qytetarëve lidhur me realizimin e të drejtave të tyre që ju takojnë sipas legjislacionit në fuqi.” Gjithashtu sipas nenit 61.3 të kësaj rregullore ceket se ”Palët , të autorizuarit e tyre dhe përfaqësuesit e tyre, sipas kërkesës së tyre , lidhur me statusin e lëndës i njofton zyrtari nga shkrimorja e gjykatës brenda një afati të arsyeshëm kohor.”

Andaj në rastin konkret gjyqtari e ka përfunduar lëndën dhe pjesa tjetër që ka të bëjë me ecurinë e mëtejme të lëndës gjer tek arkivimi i takon Zyrës së Menaxhimit të Lëndëve dhe zyrtarëve të cilët punojnë në këtë zyre dhe nuk është më kompetent gjyqtari ose zyra e gjyqtarit.

Andaj, si Autoritet Kompetent bazuar në të lartcekura konsideron se gjyqtari F.K., në veprimet e tij nuk ka pasur shkelje të cilat konsistojnë me shkeljet disiplinore të parapara me nenin 5 par.2 të Ligjit për Përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve ku është paraparë shkelje sa i përket sjelljes, qoftë kur është në detyrë apo privatisht, të cilat dëmtojnë reputacionin e gjykatës ose mund të dëmtojnë besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e gjyqësorit.

Për arsyet e cekura më lartë, Autoriteti Kompetent — Kryetarja e Gjykatës ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 lidhur me nenin 17 paragrafi 5 të Ligjit nr.06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

GJYKATA THEMELORE Në PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.6/2024, me dt.19.07.2024



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e paraparë e drejta e ankesës.